**VENDIM**
**Nr. 639, datë 6.11.2017**

# PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË AGJENCISË SË AUDITIMIT TË PROGRAMEVE TË ASISTENCËS, AKREDITUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

*(ndryshuar me VKM nr. 665, datë 19.10.2022; nr. 669, datë 30.10.2024)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 21, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore" dhe të pikës 4, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, të jetë sipas skemës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Organika e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, të jetë sipas skemës 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Numri i punonjësve të Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, të jetë gjithsej *23 veta*.
4. Vendimi nr. 930, datë 28.12.2016, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2018.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

**Skema 1**

**STRUKTURA E AGJENCISË SË AUDITIMIT TË PROGRAMEVE TË ASISTENCËS, AKREDITUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN**



SKEMA 2

ORGANIKA E AGJENCISE SE AUDITIMIT TE PROGRANIEVE TE ASISTENCES,
AKREDITUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN

*(ndryshuar numri i audituesit të parë në ndarjen IV me VKM nr. 665, datë 19.10.2022; ndryshuar me VKM nr. 669, datë 30.10.2024)*

| NR | POZICIONI | KATEGORIA | NUMRI |
|---|---|---|---|
| I. | **Drejtori i Përgjithshëm** | I-3 | 1 |
| | | | |
| II. | **Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm** | II-1 | 1 |
| | | | |
| III. | **Drejtoria e Auditimit të Programeve IPA** | | 7 |
| | | | |
| | Drejtor | II-1 | 1 |
| | Auditues i Parë | II-1 | 3 |
| | Auditues i Dytë | III-1 | 3 |
| | | | |
| IV. | **Drejtoria e Auditimit të Programeve IPARD** | | 7 |
| | | | |
| | **Drejtor** | II-1 | 1 |
| | Auditues i Parë | II-1 | 4 |
| | Auditues i Dytë | III-1 | 2 |
| | | | |
| V. | **Drejoria e Financës dhe Juridike** | | 7 |
| | | | |
| | **Drejtor** | II-2 | 1 |
| | | | |
| | **Sektori i Financës dhe Administratës** | | 3 |
| | Përgjegjës Sektori | III-2 | 1 |
| | Specialist (Buxhet/Financë) | IV-2 | 1 |
| | Specialist (Burime Njerëzore/ Arkiv Protokoll) | IV-2 | 1 |
| | | | |
| | **Sektori Juridik dhe Marrëdhëniet me Jashtë** | | 3 |
| | Përgjegjës Sektori | III-2 | 1 |
| | Specialist (Jurist) | IV-2 | 1 |
| | Specialist (Marrëdhënieve me Jashtë) | IV-2 | 1 |
| | | | |
| | **Punonjës gjithsej** | | 23 |